GJETJA

Kalendari Julian i gjetur në dyshemenë e një kishe, që sipas studiuesve përdorej nga Europa dhe Amerika, nuk është kalendar kristian por është kalendar pagan. Është kalendar pagan sepse nuk ka prejardhje kristiane, por ka prejardhje romake-pagane... Romakët e përvetësuan nga grekët, të cilët e kishin përvetësuar nga egjiptasit, të cilët e përvetësuan nga persianët, që e kishin përvetësuar nga babilonasit... "Kalendari Kristian" apo Kalendari Gregorian, në të vërtetë është Kalendari Julian, emërtuar sipas perandorit romak, Julius Cesari.



Dyshemeja prej guri e zbukuruar në "Kishën e Fjetjes së Shën Mërisë"



Simbolet gjeometrike të Rozetës të gdhendura në gurë



Zbulohet një Kalendar Julian në dyshemenë e një kishe në Berat

Abedin Kaja

Studiuesi Dritan Çoku: Ja domethënia e rozetës qendrore në "Kishën e Fjetjes së Shën Mërisë"

Dritan Çoku është ndër studiuesit e paket që fle me ëndrrën e zbulimit të "thesareve" historike e kulturore të qytetit të tij, Beratit. Ai nuk rresht së kërkuari në minierën e historisë dhe kulturës së qytetit të shumëdritshëm, qytet që për më shumë se 24 shekuj mbart ne 'sendukun' e tij të hershëm ngjarje nga më interesantet, duke filluar që nga periudha p. e. s e deri në ditët e sotme. Këtë radhë Dritan Çoku na sjell për Gazetën një tjetër studim të bazuar në gjetje, prova dhe fakte. Behet fjale per Kalendarin Julian të gjetur ne dyshemenë e një kishe. Sipas studiuesve, Kalendari Julian-Gregorian që përdor Europa dhe Amerika nuk është Kalendar Kristian, ai është kalendar pagan. Është kalendar pagan sepse nuk ka prejardhje kristiane, por ka prejardhje romake-pagane... Romakët e përvetësuan nga grekët, të cilët e kishin përvetësuar nga egjiptasit, të cilët e përvetësuan nga persianët, që e kishin përvetësuar nga babilonasit... Kalendari Kristian apo Kalendari Gregorian, në të vërtetë është Kalendari Julian, emërtuar sipas perandorit romak, Julius Cesari, i cili me ndihmën e astronomit Sozigen nga Aleksandria, reformoi kalendarin e vjetër romak në vitin 45 para Krishtit... Në intervisten për Gazetën, Çoku na jep një pasqyrë të dhënash dhe saktësime për shpjegimin dhe funksionin e rozetes qendrore në dyshemenë prej guri të zbukuruar ne "Kishen e Fjetjes së Shën Mërisë", sot muzeu Ikonografik "Onufri" K-081. Ai na sjell një studim, ku shpjegon se çfarë tregojnë simbolet gjeometrike të Rozetës, si dhe një studim përmes skicave që botohen për herë të parë.

Çfarë është ky kalendar dhe shenjat e motivet simbolike në përgjithësi?

Në thesarin e kulturës së popullit tonë një vend të rëndësishëm zënë edhe shenjat dhe motivet simbolike të realizuara në gur, dru, metal, në qëndistari etj.. Këto lloje shenjash a motive simbolike janë shprehja ose gjuha e mjeshtrit, si një vazhdimësi e një perceptimi më të hershëm të një shoqërie primitive, e lidhur kjo me kultin e të parëve. Ato gjenden në arkitekturën popullore në gjininë e banesës, objekteve të kultit, si dhe në përmendoret mbivarrore. Gjatë këtij hulumtimi kemi marrë në shqyrtim motivet simbolike gjeometrike të ROZETËS QENDRORE (fig. 1) - si Oré Diellore & Kalendar Diellor, të realizuara në një dysheme prej guri të zbukuruar në kishën e Shën Mërisë



Dritan Çoku

së Fjetur M-081, sot Muzeu Ikonografik "ONUFRI" lagja "Kala" - BERAT.

Përse njerëzit adhuronin gurin në një epokë shumë të lashtë, që i përket periudhës së parë pas prodhimit të zjarrit? Dhe përse gurët marrin në vazhdim formë dhe bëhen statujë, duke marrë formën e njeriut?

Për arsyen e thjeshtë se guri përmban brenda tij një element të perëndishëm, elementin që si dukej, gjer atëherë e ka pasur vetem perëndia e madhe, Dielli, domethënë zjarrin. Ja përse adhurohet guri në radhë të parë e pastaj druri. Druri e mban zjarrin, por guri e ka brenda tij. Domethënë ai ruan përbrenda elementin diellor! (Aristidh Kola, Gjuha e Perëndive, Tirane, 2003, f. 69, 70).

Kryqi diellor është ndoshta simboli më i lashtë shpirtëror në botë. Ai ka qenë i përfaqësuar në ceremoni aziatike, amerikane, europiane, dhe në format e artit fetar indian që prej agimit të historisë. Formuar nga një kryq i barabartë i armatosur brenda një rrethi, ai paraqet kalendarin diellor; lëvizjet e diellit shënuar në solstice.

Pak historik të kalendarëve në qytetërimet e para?

Qysh ne agimet e qytetërimet e tyre, ndoshta më herët se të tjerët, banorët e luginës së Nilit hartuan një kalendar aq të përsosur, saqë, me pak ndryshime, ai u përdor edhe ne mesjetë, madje edhe më vone. Kalendari lindi nga nevoja e llogaritjes së vërshimeve periodike të Nilit. Sipas kalendarit egjiptian, viti ndahej në tre sezone me nga 4 muaj secili: sezoni i vershimeve, sezoni i mbjelljeve dhe sezoni i korrjeve. Muaji kishte 30 ditë, të cilat ndaheshin në 3 dekada. Viti kishte 36 dekada, që u kushtoheshin perendive. Në fund të vitit shtonin pesë ditë. Një kontribut tjetër i madh i egjiptianëve të lashtë në astronomi ishte ndarja e ditë-natës në 24 orë. Që në kohen e Mbretërise se Re u bënë të njohura orët ujore dhe ato diellore.

Pa dyshim, arritje e rëndësishme e astronomisë babilonase ishte hartimi i kalendarit henor, në mesin e mijëvjeçarit II p. e. s. Sipas kalendarit që hartuan prifterinjte e tempullit të Nipurit në Babiloni, viti henor përbehej nga 12 muaj. Muajin e ndanin ne katër pjese ose ne katër javë, sipas katër fazave te hënes. Çdo muaj kishte 29-30 ditë, një kohe gati e barabartë me ciklin e plotë të katër fazave nëpër të cilët Hëna shfaqet në qiell (ky cikel kryhet ne 29, 5 dite-net). Për shkak se viti diellor ishte më i gjatë se viti henor, rreth 11 ditë, një herë në disa vite futej një muaj shtese.

Babilonasit i lanë trashëgim njerëzimit edhe një realizim tjetër që mban firmën e vulën e mendimit krijues: ndarjen e javës në ditë, të ditë-natës në 24 ore, të orës në 60 minuta dhe të minutës ne 60 sekonda. Shtatë ditët e javës babilonasit i emërtuan me emrin e diellit, hënës dhe pese planeteve që njiheshin prej tyre që në até kohë. Më vonë, kur romakët e huazuan nga babilonasit javën shtatëditeshe, i dhanë çdo dite emrin e perendive që u përgjaseshin më shumë perëndive babilonase. Java shtatëditeshe, nëpërmjet romakëve, u përhap ne tre kontinentet ku ata sundonin dhe mandej në të gjithë botën.

Një nga kalendarët e parë diellorë në botë është hartuar në epokën e dinastisë Cin në Kinën e lashtë, pra në Orientin Antik. Megjithatë, kinezet e lashtë nuk e përdorën kalendarin diellor, por përdorën kalendarin henor, të cilin e përdorin edhe sot e kësaj dite.

Astronomët e lashtë indianë e ndanin vitin diellor në dymbedhjetë muaj me nga tridhjetë ditë secili. Meqenëse viti kalendarik nuk përkonte me vitin diellor, atëherë një herë në çdo pesë vjet shtohej muaji i trembëdhjetë. (Shaban Dervishi, Qytetërimet e para, Tirane, 2008, f. 49, 50, 103, 104, 245, 246, 197)

Kalendari Julian filloi në vitin 45 p. e. s (709 AUC), si një reformë e kalendarit romak nga Julius Caesari. Ai ishte zgjedhur pas konsultimit me Sosigenesin, astronomin e Aleksandrisë, dhe është projektuar ndoshta për të përafruar vitin tropikal (i njohur te pakten qe nga viti Hipparchus). Kalendari Julian ka një vit të rregullt me 365 dite te ndare ne 12 muaj, me një dite te shtuar ne shkurt, çdo kater vjet. Viti Julian është, pra, mesatarisht 365,25 dite i gjate. Motivimi per reformimin e kalendarit është për te rregulluar numrin e diteve ne mes te kthimit te ciklit te stinëve (per shembull nga ekuinoksi i Pranverës tek ekuinoksi i Pranverës së ardhshme), ne menyre që kalendari te mund te perdoret si një ndihme per mbjelljen e sezonit dhe te tjera gjera te lidhura me aktivitetet. Cikli i stinëve (viti tropikal), ka qene i njohur që nga koherat e lashta,dhe duhet te jete rreth 365 e 1/4 dite i gjate.

Ndikimet e këtij kalendari u ndjenë edhe ne vendin tone. Kalendari Gregorian, i njohur edhe si kalendar perendimor, apo kalendari i krishtere, është kalendar civil i pranuar ndërkombetarisht. Ai u prezantua nga Papa Gregori XIII nga një dekret i nenshkruar më 24 shkurt 1582. Ky e diferencoi veten me 12 dite nga Kalendari Julian. Megjithatë, ky i fundit u njoh me fanatizem nga shqiptaret deri ne kohet e vona. Nëse te dhenat del se, në shekullin e XX, ata perdoronin paralel edhe kalendarin e vjetër (Julian), i njohur si kalendari i punes dhe i prodhimit, edhe kalendarin (Gregorian), i njohur si kalendar kishtar katolik. Pas vitit 1912, me shpalljen e pavarësisë, Kalendari Gregorian u be kalendari zyrtar i shtetit shqiptar. (Ajet Shahu, Bazat e Etnologjisë. Tirane, 2009, f. 34)

Mund të na jepni disa shpjegime mbi kalendarë primitivë në vendin tonë?

Në vendin tone nuk ekzistone deshmi te shkruara mbi perdorimin e ndonje kalendari te lashte primitiv. Por kjo nuk do te thote qe nuk ka pasur nje te tille.

Indirekt, me deshmi gojore te percjella ne breza, studiuesit mendojne se ka ekzistuar. Kete e provojne me materialet e shumta etnologjike, te perfituara nga ceremonite e shumellojshme festive. I pari qe ka dhene shpjegime shkencore rreth ketij kalendari eshte etnologu i njohur Rrok Zojzi.

Populli yne ne origjine hyjnizoi natyren, prandaj kulti i tij primitiv është i lidhur ngushte me jeten e tij dhe me punen e tij te perditshme qe zhvillohet ne rrethin e natyres. Edhe kalendari i tij primitiv i pare është kalendari i fenomeneve periodike te natyres, i festave te saja, kalendari i punes te populluit dhe i prodhimit te punes se tij.

Gjurmet me te fuqishme dhe shume te vjetra te nje kalendari primitiv etnologa Rrok Zojzi i gjeti ne krahinen e Lunes, te cilat e ndihmuan per tu theluar ne kete fushe.

Fillimi i vitit, sipas shenimeve te mbledhura, eshte Shen Gjergji ose ne shkurtim Shegergji. Per kete arsye ne shume vende, si ne Lunje dhe gjetiu, Shegergji thirret si kryet e motmotit. Viti ka 365 dite, që perfshihen brenda dy Shengjergjave. Shen Mitri e ndan vitin ne dy pjese ose ne dy stine te medha: ne dimer dhe ne vere. Per popullin tone, vera fillon me Shengjergj dhe mbaron me Shenmiter; dhe dimri fillon me Shenmiter dhe mbaron me Shengjergj.

Kurdohere dielli eshte mbajtur burimi kryesor →


Kalaja e Beratit

sor i mirësive të natyrës, prandaj ndër të gjithë popujt primitivë dielli u hyjnizua dhe njihej si një ndër hyjnitë më të para. Edhe kalendari ynë e ka brumin në këtë kult. Nga kalendari ynë primitiv rezulton se viti përsëtohet në tetë periudha, ose muaj mund t'i thërrasim, (por se populli nuk i njeh me këtë emër) me nga 45 ditë secili. Katër prej tyre bëjnë pjesë në stinën e dimrit dhe katër në stinën e verës.

Kalendari primitiv i popullit tonë nuk pati qëllim të masë kohën, sa pati qëllim të rregullojë punët e përditshme të popullit sipas kohës, prandaj ky kalendar pikësëpari është kalendar i punëve të popullit, është kalendar i jetës së tij. (Rrok Zojzi, Buletini i Institutit të Shkencave, Gjurmët e një kalendari primitiv në popullin tonë, f. 87,91,92,94,95,107,108,110)

Johan Georg von Hahn, i cili jep shpjegime në botimin "Studime shqiptare" në "Shënime mbi kalendarin e Rizës" thotë se: Dita e parë e shtatorit është fillimi i vitit të ri. Në këtë ditë kanë zakon të përtërijnë brumin e ri të bukës me lëng rrushi të papjekur, kurse sipas etnologut Rrok Zojzi fillimin e vitit e shënojnë festat e Shëngjergjit. Më pas, Han vazhdon me muajt e tjerë deri në gusht: Përmbajnë festat kalendarike, veprimtaritë në fushatat bujqësore etj. , mbanin si pikë referimi hapësirën kohore sipas muajve përkatës. Në muajin gusht, 12 ditët e para të tij tregojnë kohën e 12 muajve të motit. Koha e ditës së parë i përket gushtit, së dytës shtatorit, së tretës tetorit etj. . (Johan Georg von Hahn, Studime shqiptare, f. 213, 214, 216) OBJEKTI: Kisha e Shën Mërisë së Fjetur, sot Muzeu Ikonografik "ONUFRI", K-081 lagjia "Kala"-BERAT (fig. 2,3). Ngrihet në pjesën më të lartë të lagjes; dikur ajo përbënte një kompleks me godinat e mitropolisë.

Kronikani turk Evlija Çelebi, i cili i bën një përshkrim kështjellës së madhe të Beratit, përmend 8 kisha. Njëra prej tyre është e stolisur shumë, e madhe, e mbajtur mirë. (Vafsi Samimi, Berati "300 vjet më parë", Një studim mbi Evlija Çelebiun mbi qytetin dhe kështjellën e Beratit, Tiranë, 1971, f. 29)

Kjo faltore, e rindërtuar në vitin 1797, është monumenti më përfaqësues i arkitekturës pasbizantine për qytetin e Beratit, i cili ndërkohë kishte një nivel të lartë në ndërtime të gjinive të tjera. (A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Berati, historia dhe arkitektura, Tiranë, 1988, f. 61)

Mbishkrimi (fig. 4) gjendet i gdhendur mbi gurin portal të kishës Fjetja e Shën Mërisë, në Kala të Beratit, me gërma të mëdha në reliev. Kisha është bazilikë trinefëshe me thollo, me madhësi 23x77, 20m. (Theofan Popa, Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë, 1998,f. 113). Objekti paraqet një vëllim kompakt, që përbëhet nga naosi me kthinën e altarit, një sërë mjedisesh ndihmëse njëkatëshe në anën veriore, dykatëshe në atë perëndimore dhe portiku me arkada mbi shtylla guri. Në katedrale hyhet nëpërmjet një shkalle nga një portë në anën veriore dhe në anën jugore nga portiku. Një portë që e lidh me rrugën, ka dhe muri rrethues i kësaj ane. (A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Berati, historia dhe arkitektura, Tiranë, 1988, f. 61)

Çfarë është rozeta qendrore dhe kujt periudhe i përket?

Kisha ka një ROZETË qendrore në dyshemenë prej guri të dekoruar në interierin e saj. Mendojmë se kjo rozetë i përket një periudhe më të hershme, dhe jo periudhës kur është rindërtuar kisha (viti 1797). Ky element është trajtuar me shumë interes nga mjeshtrit e asaj kohe, të cilët kanë dhënë zgjidhje me format dhe motivet simbolike të shumëllojshme, me variacionet e materialeve, koloristikën e tyre për harmonizimin me volumin e përgjithshëm të interierit të objektit.

Perse mendoni se rozeta qendrore ka shërbyer si "Orë Diellore"?

Për orientimin e kohës ditore shqiptarët kanë përdorur mënyra të ndryshme. Rëndom ata kanë prak-



tikuar matjen e kohës sipas pozicionit të diellit në hapësirë, vështruar në raport me majat e larta të maleve. Ky pozicion ndiqej ritmikisht gjatë ciklit vjetor të lindjes së tij. Duke vëzhguar ndriçimin e majave të maleve në mëngjes, në varësi të lëvizjes në hapësirë, ata bënin përshkallëzimin e kohës. (Ajet Shahu, Bazat e Etnologjisë, Tiranë, 2009, f. 34)

Në rastin tonë do të mundohemi të ofrojmë disa të dhëna për funksionin e Rozetës,(fig. 5) dimensionet e së cilës janë 283cm x 287cm. Leximin e saj do ta bëjmë nga qendra e emblemës, në fillim si orë diellore. Në sipërfaqen e kupolës kemi dy hapësira rrethore me xham, dritare të vogla (baxha) nga ku depërton drita mbi dyshemenë e gurit me ornamente gjeometrike dhe motive simbolike. Qendra e Rozetës përkon pingul me kupolën. Ky burim drite është studiuar në mënyrë të atillë që ai të jetë i orientuar dhe të depërtojë në vendin e duhur.

Mozaikët (në rastin tonë Rozeta qendrore), sidomos në kisha, janë realizuar në varësi të trajtimit arkitekturor. Pozicionimi i tyre shpreh një botëkuptim, duke u lidhur edhe nga ana simbolike. Mozaikët realizoheshin në qendër të dyshemesë, kompozimi i kishës zakonisht ishte me kupolë, ku qendra e së cilës përkonte pingul me qendrën e mozaikut. (Dritan Çoku, Gjurmë e një sinagoge në kalanë e Beratit, Bocet, f. 33)

Në sipërfaqen sferike të kupolës është pikturuar Krishti Pantokrator, dhënë nëpërmjet një stili monumental, që thekson më tepër aspektin final të Zotit-Sundues të Universit, i cili do të vijë të gjykojë të gjallë e të vdekur. Ky stil, zakonisht është më tepër i përdorshëm në afreske, ku Pantokratori zotëron pikën më të lartë të interierit të dekoruar me skena, profetë e shenjtorë, dhe ku të krijon plotësisht ndjenjën e Sunduesit të Universit. (Kliti Kallamata, Ikona, Athinë, 1998, f. 48)

Tipi ikonografik i Krishtit Pantokrator - Sundimtar i Gjithësisë, Zot i Zotave, Zot i Botës, Gjithëmbajtës e Gjithëprirshës, shpreh atë që pa në ëndërr Profeti Daniel (Dan. 7,14-14), Madhështinë Hyjnore të Krijuesit dhe çiruesit. Emri Pantokrator mësohet për herë të parë nga përkthimi në greqisht i Dhiatës së Vjetër, ndërsa në Dhiatën e Re përmendet më tepër (Apok. 19,6,16; 14).

Konceptimi i kësaj harmonie dhe vlerësimi është dëshmia e lidhjes dhe komunikimit të hyjnores me tokësoren. Përveç këtij koncepti, kompozimi i Rozetës është menduar e realizuar në përputhje me rregullat astronomike, duke i dhënë këtij objekti kulti të krishterë funksionin jo vetëm shpirtëror, por edhe jetësor (ora diellore & kalendari diellor për matjen e kohës). Rozeta luante gjithashtu edhe rolin dekorativ, duke u harmonizuar me pikturën murore dhe ikonostasin. Qendrën e Rozetës e zë një gur gjashtëkëndor ku kornizohet me thellim 2cm brenda sipërfaqes së gurit dhe krijon një gjashtëkëndor tjetër, po aq të baraslarguar, të cilit i brendashkruhet edhe një rrethor. Qendra e rrethorit ka një vrimë e cila korrespondon me qendrën e gurit gjashtëkëndor (fig. 7). Mendojmë se në këtë vrimë vendosej ndonjë shkop i hollë ose ndonjë element tjetër me majë të mprehtë, i cili qëndronte pingul me qendrën e gurit, pra në qendër të rrethorit. Bëhet falë për funksionin e tij si një orë diellore.

Një orë diellore është një pajisje që mat kohën nga pozita e Diellit. Në planet e përbashkëta, të tilla horizontale si orë diellore, Dielli hedh një hije sipas tij në një nivel tjetër sipërfaqeje shënuar me vija që tregojnë orët e ditës. Lëvizja e diellit nëpër qiell, drejton hijen në linja të ndryshme të kësaj ore diellore. Të gjitha orët diellore duhet të jenë një linjë me boshtin e rrotullimit të Tokës, për të treguar korrekt kohën.

Në Dimalin antik në vitin 1963 është zbuluar një fragment arkitektonik, objekti, fragment ore diellore me mbishkrim (fig. 6). Sipas përshkrimit dhe katalogimit që i është bërë objektit, i cili ndodhet në Muzeun Arkeologjik Kombëtar të Tiranës, i përket periudhës helenistike të vonë, saktësisht shek. II p. e. s. Materiali i këtij fragmenti është mermer me dimensionet: 20cm x 23cm x 14cm.

Në qoftë se në fragmentin arkitektonik të mësipërm, material mermeri, i janë thelluar linja të cilat na orientojnë për kohën, pra si orë diellore, në Rozetën qendrore të dyshemesë prej guri të kishës së Shën Mërisë së Fjetur sot Muzeu Ikonografik "Onufri", këtë orientim ne e përftojmë nga 12 segmente, ku 6 prej të cilave krijohen nga bashkimi i kulmeve të gjashtëkëndorit me vijën e rrethit dhe 6 të tjerat nga bashkimi i mesit të brinjëve të gjashtëkëndorit po me vijën e rrethit (fig. 7, 8, 9).

Hapësira ndërmjet segmenteve të orës diellore është ndarë në gjashtë pjesë nga prerjet e ndryshme, ku formohet numri gjashtë (fig. 10). Pra, 6-ta si numër biblik simbolizon 6-të ditët e javës që Zoti krijoi qiellin dhe tokën (Zan. 1,31, 2,4).

Ju mendoni se rozeta qendrore ka shërbyer edhe si "Kalendar Diellor"?

Njëra nga brinjët e gurit gjashtëkëndor është e orientuar nga lindja. Guri qendror nuk është vendosur në simetrinë e bazës fillestare katërkëndore të Rozetës. Mjeshtri që në fillimin e krijimit të kësaj skeme dhe zgjidhjes kompozicionale ka pasur parasysh funksionin dhe kuptimin që do të kishte Rozeta qendrore. Ai rrethohet nga të gjashta brinjët me gjashtë copa tullash 3cm. Në kulmet e gurit shpërndahen si rreze, gjashtë segmente që takojnë rrethorin e parë prej copa tulle. Bashkimi i të gjitha pikave na japin dy trekëndorë barabrinjës të ndërthurur me njëri tjetrin dhe që formojnë një yll me gjashtë cepa (fig. 11).

Disa studiues kanë edhe teorinë e Yllit që paraqet situatën në kohën e lindjes enigmatike të Davidit apo kurorëzimin e tij si mbret. Ylli i Davidit është gjithashtu i njohur si ylli i Mbretit në qarqet astrologjike, dhe ishte gjithashtu një simbol astrologjik në Zoroastrizëm.

Në shek. VII-VI p. e. s. në Azinë e Mesme ose në Iranin Lindor lindi zoroastrizmi, dh. m. th. doktrina fetare e themeluar nga Zoroastri (Zaratushtra), prej të cilit mori emrin. Sipas kësaj doktrine, Ahura Mazda (Ormuzdi), siç e quanin grekët, ishte perëndia e Së Mirës, mishërimi i dritës, i jetës dhe i së vërtetës. Zoroastrizmi filloi të përhapej në Persi në kapërcyellin e shek. VII-V p. e. s. , d. m. th. në periudhën e mbretërimit të Darit I. (Shaban Dervishi, Qytetërimet e para,Tiranë, 2008, f. 171)

E ofruam këtë shpjegim për vetë faktin se në qytetin e Beratit dhe sidomos në Kalanë e Beratit kemi një prani të simbolit të Yllit të Davidit në objekte të ndryshme. Në rastin që po shpjegojmë si me siguri ky simbol ka një përputhje me rregullat astronomike ku së bashku me elementet e tjerë na e ofrojnë këtë fenomen.

Ky motiv apo simbol mjaft i përhapur; ka qenë dhe është mjaft i përdorshëm, jo vetëm në kontekstin e simbolit hebraik, sidomos në ato qytete që ka pasur prani dhe zhvillime të komunitetit hebre me vendin tonë, por edhe si një element dekorativ mjaft interesant, i cili më pas u bë firmë e grupit të punës së mjeshtrave që kontribuuan në realizimin e zbukurimeve të interierit në banesat e qytetit të Beratit. (Dritan Çoku, Gjurmë e një sinagoge në kalanë e Beratit, Bocet, f. 79)

Dymbëdhjeta është tradicionalisht një numer dallor. Në kemi 12 muaj në vit, 12 shenjat e zodiakut, 12 fise e Izraelit, 12 fillesat e mëdha të ADN-së, dhe kështu më radhë.

Dymbëdhjetë gurë në formë drejtkëndori me dimensione 47cm x 37cm x 20cm, të cilët qarkojnë emblemën qendrore, tregojnë 12 muajt e vitit (fig. 13, 14). Brenda emblemës qendrore janë vendosur dy trekëndorë. Çfarë ka dashur të tregojë krijuesi i Rozetës nëpërmjet kësaj vendosjeje? Çfarë tregon trekëndori, ku njeri prej kulmeve është i orientuar nga guri i bardhë?

Dhe ne themi, se formimi i këtij trekëndori krijohet nga bashkimi i një prej katër elementeve të tokës, siç është Zjarri tri here në harkun e dymbëdhjetë muajve, por edhe fillimin e ekuinoksit pranveror.

Ndërsa trekëndori i dytë, i cili ndërthuret me trekëndorin e parë, krijohet nga bashkimi i një tjetri elementi të Tokës, që është Ajri. Konfigurimi i trekëndorit, pra numri 3, në zbulesë shënon Hyjin e numrit 4, Tokën. Mbledhja e tyre, 7-ta, shënon vepërtuarinë e përsosur të Hyjit në gjithësi ose vetë Hyjin ndërsa banon ndër njerëz. Por brenda kësaj embleme ne kemi një yll tjetër me gjashtë cepa, i cili është krijuar nga bashkimi i elementeve Tokë & Ujë. Dymbëdhjetë copat e tullës që janë të vendosura në prerjen e simboleve, yllit me gjashtë cepa dhe dy trekëndorëve të ndërthurur në drejtim të dymbëdhjetë gurëve që tregojnë muajt, na ofrojnë mundësinë për të lexuar 12 shenjat e zodiakut. Hapësira prej 2 copa tullash i përkon një shenje zodiaku (fig. 14, 15).

Në hapësirën e emblemës qendrore nga guri heksagonal deri tek gurët që shprehin muajt ndodhen 72 pjesë (fig. 16), të cilat janë formuar nga prerjet e drejtëzave që kalojnë në të. Numri 72 është numri i viteve të një shkalle të një "moshe" "Mazzaroth" / zodiakal. Rrethi i zodiakut është 360 gradë, të ndara nga 12 (yje / shenjat.)Secila nga këto 12 shenja të Mazzaroth / Zodiak zë 30 gradë të qiellit. Çdo 30 seksione shkallë është quajtur një "muaj i zodiakut" në "vitin e zodiakut" të madh. Kjo shifër, 72 vite, është në harmoni të plotë me praktikat e Kabalës dhe përfaqëson numrin e viteve të jetës së një njeriu.

Midis linjës së dytë dhe të tretë perimetrale rrethore prej tulle kemi 30 trekëndorë prej qeramike dhe 30 trekëndore prej guri (fig. 17, 18). Mjeshtri i ka vendosur në mënyrë të atillë që ato të shpërndahen jo vetëm si rreze diellore, duke e konceptuar edhe grafikisht me anë të kolorit, por edhe duke lexuar numrat e materialit të qeramikës dhe të gurit 30 ditë dhe 30 net, duke rënë në të dukshme të natyrës, pra dita dhe nata si bazë për matjen e kohës. Të 30 copat e qeramikës janë ditët e muajit, dimensionet e të cilave janë 31cm x 9x3cm.

Katër rrethorët prej qeramike me dimension 20cm, që janë vendosur në meset e brinjëve të katërkëndorit, japin orientimin gjeografik, veri-jug-lindje-perëndim (fig. 19). Ndërsa shenjat e orientuara nga kulmet e katërkëndorit janë solsticet dhe ekuinokset (fig. 20), të cilat lexohen përkatësisht:

1- Guri i bardhë - Ekuinoksi pranveror; i përkon 21 marsit dhe fillimit të vitit, prandaj mendojmë se jo pa qëllim është edhe ndryshimi në kolorin e guri.

2- I dyti është solstici veror më 22 qershor.

3- I treti, ekuinoksi vjeshtor më 23 shtator.

4- I katërti, solstici dimëror më 22 dhjetor.

Me këto të dhëna, shpjegime dhe saktësime jemi munduar të kuptojmë teknikën e realizimit dhe ndërtimit të Rozetës, por gjatë studimit kemi arritur ta zbërthejmë, duke u thelluar jo vetëm në realizimin e tyre, por edhe në faktorët shtytës të konceptimit funksional (si orë e kalendar diellor), kompozimit artistik, fetar dhe teknik lidhur me ndërtimin arkitekturor të objektit, duke e konkretizuar me skicat, të cilat botohen për herë të parë.